

DANJA SINANAJ

NJË FJALOR TRIGJUHËSH I SË DREJTËS MIRATUAR ME LIGJ

I.

Në Arkivin Qendror Shtetëror (F. 146, V. 1928, D. 30, fl. 38-48) ruhet një fjalor trigjuhësh i së drejtës (titulli në origjinal: *Fjaluerth mbi termat juridike të përdoruna në Kodin Civil*), shqip-frëngjisht-turqisht. Fjalori është hartuar nga Komisioni Ligje-përgatitës i Parlamentit në vitin 1928, i është dërguar Dhomës së Deputetëve nga Ministria e Drejtësisë¹ dhe është miratuar *tue e pranue me ngutsi prej Komisijës së Drejtësisë* vetëm dy ditë pas dërgimit², e më tej duke ndjekur procedurat e tjera, u miratua edhe nga Senati, *të nesërmen e përcjelljes së tij*³. Qëllimi i fjalorit ishte *me u lehtësue gjyqtarëve aplikimin e Kodit Civil, që kuptimet e termave në fjalë të marrin formën e një interpretimi autentik*.

Ky fjalor përmban afërisht 500 terma reference në gjuhën shqipe, shpjeguar me referencë juridike ndërkombëtare në kuptimet e tyre në gjuhën frënge. Siç del prej burimeve, turqishtja është shtuar si gjuhë e tretë për të shmangur konfuzionin që mund të shkaktonte përdorimi joterminologjik i fjalëve-terma të periudhës osmane, praktikisht të Sherijatit, ende me veprim për inerci në praktikat e gjyqimit dhe të dhënies së të drejtës në Shqipëri. Pas shfuqizimit të ligjeve të Sherijatit dhe rënies së institucionit të kadinjve, termat e turqishtes e humbën saktësinë dhe kishin nevojë jo vetëm për ekuivalentin shqip, por dhe për një term garantues në një gjuhë të huaj (frëngjisht, në këtë rast dhe kjo nuk është një rastësi).

Ky është i vetmi fjalor terminologjik i miratuar me ligj dhe i cilësuar pjesë e Kodit Civil, të cilit i vjen në ndihmë.

Në bazë të paragrafit II, të nenit 32 të Statutit, qeveria shqiptare krijoi një komision të posaçëm për të përgatitur Kodin Civil dhe ligjin mbi aplikimin e tij⁴. Komisioni i Posaçëm ishte ai që e elaboroi këtë kod dhe për këtë arsye konsiderohet si *guri ma i çmueshem të kunorës së drejtësisë Shqiptare*⁵.

Në raportin e komisionit të posaçëm theksohet se shoqëria ka ndryshuar dhe se rregullimet e mëparshme civile nuk përputheshin më me rrethanat. Zhvillimi shoqëror nxori në dukje të metat e regjimit të mëparshëm juridik dhe për këtë arsye, u pa e nevojshme reforma e menjëhershme civile. *Kodi Civil nuk asht tjetër veçse pasqyra qi çfaqë menyren e rregullimit të veprimeve shoqenore, në*

¹ AQSH, F. 146, V. 1928, D. 30, fl. 38, *Bisedim mbi Kodin Civil*.

² Po aty, fl. 48.

³ Po aty, fl. 57.

⁴ AQSH, F. 146, V. 1928, D. 87, fl. 75, *Mbledhja 5, e hanë, 12 mars 1928, Bisedim mbi Kodin Civil për herën e dytë (dalë nga komisioni)*.

⁵ Po aty, fl. 76.

*përshtatje me nevojat e tradicjonet e shoqënis, edhe shkallen e përparimit të sajë, shprehej komisioni në raportin e tij*⁶.

Kodi Civil i vitit 1928 erdhi si nevojë natyrale për të zhvilluar shoqërinë, pasi ishin marrë masat e para drejt konsolidimit të pushtetit monarkik. Kodi ishte një reformë e rëndësishme ligjore, duke qenë se rregullimi fetaro-ligjor nuk i ndiqte dot nevojat e qytetërimit, që po tentonte të ecte përpara.

Ashtu sikurse kodi, edhe ky dokument që po paraqesim ka një vlerë shumë të rëndësishme historike. *Fjalori i termave juridikë* shërbeu për të plotësuar *vacuum*-in terminologjik, problemet kuptimore dhe njësimin e gjuhës juridike, për ta shkëputur një herë e mirë rendin juridik nga e drejta osmane, e drejta e Sherijatit. Për provuar këtë, kemi marrë disa shembuj si më poshtë.

II.

Termi *tagër*, që në frëngjisht është përkthyer *faculté*, në gjuhën turke përdorej me kuptimin *hak*⁷. Në të vërtetë, në *Fjalorin e orientalizmeve*, në përdorimin si huazim në shqip termi *hak* është shumë më i gjerë se sa kuptimi *tagër*. *Haku*, sipas këtij fjalori, është *një e drejtë, arsyeja dhe e vërteta*⁸. T'i japësh dikujt hakun do të thotë se e ka merituar, dhe për këtë arsye ai shpërblehet, shpagohet apo zhëmtohet sipas rastit. Haku ishte gjithashtu puna, paga që duhet të merrte një punëtor: *Kaq të takon haku?*. Haku i tokës është prodhimi që del prej saj, prej së cilës pronari merr të tretën apo gjysmën e prodhimit. Haku është edhe hakmarrje apo shpagim: *Mori hakun e babait që i patën vrarë*.

Ndërsa *faculté*, në *Leksikon e Termave Juridikë* nënkupton: *Një mundësi zgjedhjeje përpara një situatë juridike. Kjo mund të akordohet me anë të ligjit apo konventave dhe i lejon përfituesit të zgjedhë midis disa opsioneve, në mënyrë që të mundësojë lindjen e një situatë juridike, apo të pengojë atë. Këto mundësi zgjedhjeje kushtëzohen edhe nga vendimet që mund të marrë trashëgimlënësi. Në një kuptim më të gjerë, këto zgjedhje shprehin ushtrimin e një të drejte themelore*⁹.

Tagri është një term që përdoret ende për të shprehur mënyrën se si mund të realizojë një pronar të drejtën e tij ndaj një sendi të caktuar¹⁰. Këtë ai mund ta bëjë vetëm nëpërmjet ushtrimit të tri elementëve, siç janë posedimi, gëzimi dhe disponimi i sendit. *Tagri*, pra, është në një farë mënyre, kombinimi i tri pushteteve mbi një send, që krijon figurën e pronarit dhe rregullon marrëdhëniet me të tretët.

⁶ AQSH, F. 146, V. 1928, D. 87, fl.76, *Mbledhja 5, e hanë, 12 mars 1928, Bisedim mbi Kodin Civil për herën e dytë (dalë nga komisioni)*.

⁷ AQSH, F. 146, V. 1928, D. 30, fl. 46, *Bisedim mbi Kodin Civil*.

⁸ T. N. Dizdari: *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë 2005, bot. Instituti shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islam, f. 333.

⁹ *Lexique des termes juridiques*, 16^{ème} édition, Dalloz, Paris 2007, f. 300.

¹⁰ V. Kondili: *E drejta civile*, II, pjesa e posaçme, Geer 2008, f. 50.

Ky term është përdorur për të treguar një të drejtë procedurale, siç është *padia e kthimit*, apo e *ankimimit*, duke marrë si pikë reference termin në gjuhën frënge *recours*. Në turqisht termi i përdorur në mënyrë të saktë është *haki ruxhuë*¹¹.

Padia e kthimit përcaktohet kështu: *Personi që ka shpërblyer dëmin ka të drejtë të kërkojë nga secili shkaktar i dëmit pjesën e tij në përpjesëtim me shkallën e fajësisë të secilit dhe të tërësisë së pasojave të rrjedhura. Kur kjo nuk mund të përcaktohet, prezumohet se shkalla e fajësisë është e barabartë*¹².

Për ta thjeshtëzuar, në rast shkaktimi dëmi në mënyrë kolektive, ndaj të dëmtuarit përgjigjet një person i vetëm. Ky i fundit, i drejtohet të tjerëve me padi kthimi për të ndarë fajësinë dhe shpërblimin e dëmit.

Recours në gjuhën frënge është e drejta për t'iu drejtuar administrativisht një institucioni shtetëror, apo gjykatës, në mënyrë që të anulohet një akt i pretenduar si i paligjshëm, apo për të kërkuar riparimin e dëmit të shkaktuar nga të tretë¹³.

Termi *pronë*, që në frëngjisht është përkthyer *immeuble*, në gjuhën turke ka marrë disa kuptime, ndër të cilat është përdorur edhe termi *mylk*¹⁴. Në sinonimet e përdorura për këtë fjalë janë: *pronë e madhe, toka, kullosa, vëneshta, pyje, çiflik, bashtinë, petk: E mban mylku prandaj ka kohë me ba gjyq*¹⁵. Në këtë rast, është termi në gjuhën frënge që shkaktonte konfuzion, për shkak se *immeuble* do të thotë *ndërtesë / pronë e paluajtshme*. Fakti që përpara hyrjes në fuqi të Kodit Civil nuk bëhej ndonjë ndarje e mirëfilltë juridike midis sendeve të luajtshme dhe atyre të paluajtshme, mund ta justifikonte këtë paqartësi. Sendet e luajtshme nuk kishin ndonjë vlerë në raport me sendet e paluajtshme në rendin e vjetër juridik osman. Me hyrjen në fuqi të kodit, u legjitimua ndarja midis tyre.

Në *Leksikon e Termave Juridike*, koncepti *immeuble* përcakton se bëhet fjalë për: *çdo tokë dhe gjithçka e lidhur me të (sende sipas natyrës), ashtu sikurse të gjithë sendet e luajtshëm që shërbejnë për shfrytëzimin e saj (sende sipas destinacionit) përbëjnë pronë. Edhe të drejtat që lidhen me to konsiderohen pronë. Somma divisio, të gjithë sendet janë të luajtshëm e të paluajtshëm. Rezulton nga jurisprudenca se, të gjithë sende që nuk përcaktohen si sende të paluajtshëm nga kodi, janë detyrimisht sende të luajtshëm*¹⁶.

Kurse neni 774 i Kodit Civil të vitit 1929, parashikon që *sendet janë të paluajtshme o prej natyre, o prej destinimit, ose prej objektit të cilit i referohen*¹⁷.

Termi *trashëgimtari*, që në frëngjisht është përkthyer *institution d'héritier*, në gjuhën turke ka për referencë termin *varis*. Në fakt, në këtë rast synohet të

¹¹ AQSH, F. 146, V. 1928, D. 30, fl. 42, *Bisedim mbi Kodin Civil*.

¹² *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*, Qendra e Publikimeve Zyrtare, tetor 2012, neni 627, paragrafi 1, f. 194.

¹³ *Lexique des termes juridiques*, 16^{ème} édition, Dalloz, Paris 2007, f. 547.

¹⁴ AQSH, F. 146, V. 1928, D. 30, fl. 45, *Bisedim mbi Kodin Civil*.

¹⁵ T. N. Dizdari: *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë 2005, bot. Instituti shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islam, f. 684.

¹⁶ *Lexique des termes juridiques*, 16^{ème} édition, Dalloz, Paris 2007, f. 343.

¹⁷ *Kodi Civil i Mbretërisë së Shqipërisë*, 1 prill 1929, neni 492, bot. *Papirus*, Tiranë 2010, f. 273.

përkufizohet termi i *institucionit të trashëgimisë*, kurse termi në turqisht sipas kuptimit të shqipfolësit nënkupton *trashëgimtarin* në vetvete. Kështu, *Fjalori i orientalizmave* shprehet se *varis* është një fjalë që *ndigjohet ma së forti në të folmen e Jugut ... ma së forti në krahinat e Labërisë: trashigimtar, trashigues*, duke vënë përkrah edhe termin sinonimik në italisht *erede*¹⁸. Kjo fjalë konsiderohet deri-diku moderne. T. Dizdari shprehet se bëhet fjalë për një fjalë të ditëve të sotme. Vargu i një kënge partizane e dëshmon këtë: *Më të prapë varis lanë-dorëzeza!*, që nënkupton se dëshmorët, sado që lanë jetën në luftë, lanë shokë të tjerë pas tyre.

Ndërsa *emërimi i trashëgimtarit*, që në frëngjisht është përkthyer po njëlloj si vetë trashëgimtar, *institution d'héritier*, në turqisht është më i saktë në formën *varis taëjin itmeq*¹⁹.

Termin *varis* e gjejmë gjithashtu për sinonimin e tij, gjithashtu huazim në gjuhën shqipe, *sukcesor*, që në frëngjisht është *successeur*²⁰. Suksesori nuk ka asnjë lloj dallimi me trashëgimtarin. Nuk është e kuptueshme pse do të duhej të vendoseshin në fjalor të dy termat, ku të dy kanë të njëjtin përkufizim juridik.

Succession, sipas Leksikut të Termave Juridike nënkupton *transferimin e sendeve të një personi të vdekur*. Dhe më tej: *Në një kuptim të dytë, mund të themi që është edhe transferimi i pasurisë. Transferimi i pronës ab intestat rregullohet me ligj, në kushtet kur mungon testamenti, qoftë edhe në kundërshtim me vullnetin e trashëgimlënësit. Trashëgimia testamentare rregullohet sipas vullnetit të trashëgimlënësit, i cili shprehet nëpërmjet testamentit*²¹.

Ndërsa *successeur* është personi që thirret për të marrë një trashëgimi (p.sh., të jesh familjar i radhës së parë midis trashëgimtarëve).

Një term tjetër interesant për t'u studiuar është termi *vasijet*, *vasijet kanunije*²², që në *Fjalorin Juridik të Termave* merr disa kuptime: *testament*²³, *tutor*, *leg*. Më poshtë do të marrim me radhë kuptimin e këtyre termave, por fillimisht po japim kuptimin e termit *vasijet*, sipas *Fjalorit të orientalizmave*²⁴.

Vasijet: çfaqje e vullnetit të vet të fundit, me gojë a me shkrim, të një njeriu që asht me një kambë në vorr. Me anë të asaj çfaqje, disponohet për gjanë a sendet e zotnueme si dhe për porositë e dëshirat e mrame; dhjatë, testament.

Një ndër porositat e fundit të një njeriu kur parandien se vdekjen do ta ketë të afërme ose edhe tue qenë tumirë e shëndosh: E ka lane me vasijet mos me e qa për së vdekunit (e ka lanë me gojë për s'të gjallë).

¹⁸ T. N. Dizdari: *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë 2005, bot. Instituti shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islam, f. 1080.

¹⁹ AQSH, F.146, V. 1928, D. 30, fl. 40, *Bisedim mbi Kodin Civil*.

²⁰ Po aty, fl. 46.

²¹ *Lexique des termes juridiques*, 16^{ème} édition, Dalloz, Paris 2007, f. 622.

²² AQSH, F. 146, V. 1928, D. 30, fl. 47, *Bisedim mbi Kodin Civil*.

²³ Po aty.

²⁴ T. N. Dizdari: *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë 2005, bot. Instituti shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islam, f. 1081-1082.

*Porosi e lanun prej një kreut të familjes dhe e respektueme brez mbas brezit:
Shtëpija e jonë e ka si me vasijet mos me mbajtë përllumba, pse nuk barin truejme.*

Pa degjo Velo Sinani

Për vasijete që le,

O fillozofi me mënde,

Si Bismarku në More/.

(vjershë popullore në Borsh)

Pra, në kuptim të *Fjalorit* të Dizdarit, fjala *vasijet* ka kuptimin e amanetit, testamentit, apo të një porosie të trashëgimlënësit tek pasardhësit e vet, qoftë e shkruar, apo me gojë, shprehja e vullnetit të këtij të fundit. Është interesante të thuhet se në asnjë prej shembujve nuk përmendet vullneti për të disponuar pasurinë, por përmenden porosi të tjera që mund të lerë trashëgimlënësi, si nderi i familjes, kujdesi për vajzat e pamartuara ende, nderi i shtëpisë etj. Kjo krejt ndryshe nga çfarë parashikohet juridikisht, si ... *një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes*²⁵.

Testament në kuptimin juridik në legjislacionin francez nënkupton *aktin juridik unilateral, mbi bazën e të cilit një person, trashëgimlënësi, shpreh vullnetin e tij të fundit dhe disponon pronën e tij për të tjerë, pas vdekjes së tij. Më në detaje: Testamenti autentik realizohet në prani të dy noterëve, ose në prani të një noteri dhe dy dëshmitarësh. Testamenti olograf është ai që realizohet tërësisht me shkrimin e trashëgimlënësit, me datë dhe nënshkrim prej tij*²⁶.

Ndërsa përsa i përket kuptimit që i jep Kodi Civil i 1929, neni 492 përcakton se *testamenti asht një akt i revokueshëm, me të cilin ndokush, simbas rregullave të caktueme prej ligjës, disponon për kohën mas vdekjes, të tanë ose një pjesë të pasuniës së vet në favor të një ose ma shumë personave*²⁷.

Ndërkohë, *vasijet* përdoret për termin *tutor*, apo kujdestar ligjor (terminologji e ditëve të sotme). Në fakt, një kujdestar ligjor, *vasijeti kanunije* mund të jetë pjesëtar aktiv, sepse është ai që kërkon kryerjen e inventarit të pasurisë trashëgimore, merr masa për administrimin e pasurisë, ushtron të drejtën e padisë dhe u përgjigjet padive në lidhje me këtë pasuri, depoziton në bankë paratë që ndodhen në trashëgim ose që rrjedhin prej tij, kryen veprime të tjera të kësaj natyre dhe jep llogari në mbarim të administrimit.

Me miratimin e gjykatës, kujdestari paguan detyrimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore, ekzekuton detyrimet në lidhje me leget dhe barrët dhe, kur shihet e nevojshme tjetëron edhe pasuri trashëgimore. Detyra e kujdestarit pushon me paraqitjen e trashëgimtarit²⁸.

²⁵ *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Tetor 2012, neni 372 e vijues, f. 123.

²⁶ *Lexique des termes juridiques*, 16^{ème} édition, Dalloz, Paris 2007, f. 640.

²⁷ *Kodi Civil i vitit 1929*, neni 492, bot. *Papirus*, Tiranë 2010, f. 189.

²⁸ *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*, Qendra e Publikimeve Zyrtare, tetor 2012, nenet 345- 347, f. 116.

Në rastin e një trashëgimie, kur trashëgimtari është ende i mitur, apo kur është me aftësi të kufizuar dhe nuk mundet ta përdorë pjesën e tij të trashëgimisë siç dëshiron, ndërhyjnë gjithashtu roli i kujdestarit ligjor.

Mirëpo, kujdestaria është një institucion më vetë, që mund ta hasim edhe në raste të tjerë si p.sh.: në rastin e shkaktimit të dëmeve nga një i mitur apo të një personi me aftësi të kufizuar, mund të jetë kujdestari ai që përgjigjet për to²⁹. Pra, ajo që duam të theksojmë është që fjala “tutor/ kujdestar” nuk lidhet domosdoshmërisht me “testamentin”, apo vullnetin e fundit të trashëgimlënësit.

Vasijet, sipas *Fjalorit të Termave Juridike* është edhe institucioni i *legut*, që në frëngjisht termi është i saktë³⁰. Legu është gjithashtu trashëgimi dhe qëndron korrekt përse i përket sinonimit të tij në turqisht³¹. Këtu gjendemi përsëri në një farë dublimi të së njëjtës fjalë, *testament* dhe *leg*, por *legu* ndryshon nga trashëgimia e zakonshme sepse, trashëgimlënësi mund të ngarkojë trashëgimtarin ose trashëgimtarët e caktuar në testament që t’u japin një ose më shumë trashëgimtarëve ligjorë një përfitim pasuror nga trashëgimi, pa i bërë këta trashëgimtarë³².

Legu sipas kuptimit francez është *liria testamentare që merr fuqi pas vdekjes së trashëgimlënësit*. Legu mund të jetë i veçantë, që do të thotë se mund t’i përkasë një ose më shumë sendeve të përcaktuar apo të përcaktueshëm. *Ai mund të jetë universal, që jep mundësinë për të përthithur të gjithë trashëgiminë*³³.

Neni 493, i Kodit Civil të 1929, përcakton ndarjen midis legut dhe trashëgimtarit, duke shprehur se *disponimet testamentare që përfshijnë universalitetin e pasuniës të testatorit ose një pjesë (quot parts) të saj quhen me titull universal dhe apin cilësiën e trashëgimtarit. Disponimet e tjera quhen me titull partikullar dhe apin cilësiën e legatarit*³⁴.

Legatari, nga ana tjetër, nuk konsiderohet trashëgimtar, sepse nuk vihet në marrëdhënie me trashëgimlënësin, por me trashëgimtarët e tij, të përcaktuar sipas testamentit të trashëgimlënësit. Trashëgimtarët mund të ndodhen para situatash nga më të ndryshme në raport me legatarët, si p.sh.: pagesa e një shume të hollash, detyrimi për të blerë një send të caktuar në dobi të legatarit, caktimi i një të drejte siç mund të jetë e drejta e banimit etj.³⁵.

²⁹ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Tetor 2012, neni 614, f. 190.

³⁰ AQSH, F. 146, V. 1928, D. 30, fl. 43, *Bisedim mbi Kodin Civil*.

³¹ Micro Robert, *Dictionnaire du français primordial*, S.N.L.- Le Robert, Paris 1977, f. 608.

³² Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 384-385, parashikojnë gjithashtu se *legatari ka të drejtë të kërkojë frutat ose kamatat që rrjedhin nga legu, nga dita që i është caktuar dorëzimi i legut dhe në mungesë të saj, nga dita e njoftimit të kërkesë-padisë. Ato mund të kërkojnë nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit, kur trashëgimlënësi ka disponuar shprehimisht ose kur legu është një depozitë në para*.

³³ *Lexique des termes juridiques*, 16^{ème} édition, Dalloz, Paris 2007, f. 391.

³⁴ Kodi Civil i vitit 1929, neni 493, bot. Papirus, Tiranë 2010, f. 189-190.

³⁵ V. Kondili: *E drejta civile*, II, pjesa e posaçme, Geer, 2008, f. 239-240.

Saktësojmë që, trashëgimtari ka detyrimin ligjor për të përmbushur vullnetin e trashëgimlënësit, në raport me legatarin. Mirëpo, në kushtet kur pasuria trashëgimore është e ngarkuar me detyrime ndaj kreditorëve, atëherë duhen përmbushur këto detyrime, përpara se të respektohet e drejta e legatarit. Ashtu sikurse ndodh edhe me legatarin, i cili nuk ka asnjë lloj detyrimi ligjor për t'u përgjigjur ndaj të tretëve për detyrimet e trashëgimlënësit.

Gjejmë gjithashtu termin *vasijetname*, që nënkupton *aktin e vullnetit të mbreme* dhe në frëngjisht *acte de dernière volonté*³⁶, pra, *aktin e vullnetit të fundit*. Ky nuk është realisht term juridikisht i pastër, duke qenë se kupton me një fjalë të vetme *testamentin* sërisht: shfaqja e vullnetit të fundit është pikërisht ajo çka vendos trashëgimlënësi të bëjë me pronën e tij.

Termi *miri*, në shqip është përkufizuar si *domaniale* e në frëngjisht *domaine public*³⁷. Në fjalorin e Dizdarit thuhet se *mirija* është:

*Mall ose pasuni që i përket shtetit ose thesarit botuer, mall mirijet, pasuni shtetnore: e laç shkret të shkoftë për miri, jarabi (t'u shtefzofitë malli e gjaja)*³⁸.

I ka ba një punë vaki:

Kan çartë kullë e djegë shpi,

Kan qitë tokën për miri.

Tokë miri (erezi-i miriye): prona tokësore të thesarit shtetnor, që në kohë të sundimit osman të herëshme o drejt me dekret të Sulltanit, ose edhe prej sundimtarëve të përgjithshëm jepeshin si benefice ushtarake për spahitë si edhe personave të tjerë që i kishin meritue me pjesmarrje e dallime në lufta sidomos. Ka pasë raso që këso tokash - si timare të vogla - u jepeshin edhe personave joluftëtar, si imamëve të xhamijave, ndonjanit nga shtëpijat e para, dikur në za, por ramë nga vakti.

Prona shtetërore, sipas nenit 789 të Kodit Civil, ndahej gjithashtu në pasuri domaniale dhe pasuri patrimoniale. Ky nen parashikonte se *formojnë pjesë të pasuniës domaniale rrugët kombëtare, provinciale dhe krahinare, bregu i detit, limanet, lumenjtë, përenjtë dhe fortesat*³⁹. Thuhet se pjesë e pasurisë domaniale janë gjithashtu edhe pallatet qeveritare, shkollat, kazermat, sallat e sportit etj.⁴⁰. Vlen për t'u përmendur se pasuria domaniale nuk nxjerr përfitime ekonomike për shtetin dhe shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë për popullsinë. Pra në kuptim më të thjeshtëzuar, mirija, sipas sinonimit të saj në shqip nënkupton pronën publike. Edhe *domaine public* nënkupton pronën publike, që nuk mund t'i përkasë

³⁶ AQSH, F. 146, V. 1928, D. 30, fl. 39, *Bisedim mbi Kodin Civil*.

³⁷ Po aty, fl. 40.

³⁸ T. N. Dizdari: *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë 2005, bot. Instituti shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islam, f. 662.

³⁹ *Kodi Civil i vitit 1929*, neni 788-793, bot. *Papirus*, Tiranë 2010, f. 278- 279.

⁴⁰ T. Selenica: *Shqipëria në 1937*, vëll. II, Tiranë 1938, f. 1.

personave fizikë, si p.sh.: vijën e ujit, lumenjtë, rrugët, shinat e trenit, kazermat etj.⁴¹.

Ndërsa Kodi Civil në fuqi, në nenin 152 përcakton se *sendet u përkasin personave fizikë, personave juridikë dhe shtetit. Llojet e pasurisë publike caktohen me ligj.*

Domaine public nga ana tjetër parashikon që bëhet fjalë për pasuri që i përket personave publikë, e cila i nënshtrohet regjimit juridik të së drejtës administrative me karakter mbrojtës. *Sendet e kategorizuara këtu janë të paparashkrueshëm dhe të padhunueshëm. Dalja nga kjo kategori bëhet me një procedurë të njohur si deklasim. Kjo pasuri ndahet në sende të paluajtshme dhe sende të luajtshme...*⁴².

Nga ky krahasim vërehet se interpretimi terminologjik i kategorive bazë të së drejtës në periudhën midis dy luftërave ishte një problem jo vetëm tradite e mendësie, por edhe një problem leksikologjik-gjuhësor, për shkak të ekzistencës së dy rendeve kuptimorë: njëri si në ligjin e Sherijatit dhe tjetri si në shqipen popullore të mbushur me huazime orientale.

BIBLIOGRAFI

- AQSH, F. 146, V. 1928, D. 30, *Bisedim mbi Kodin Civil*.
AQSH, F. 146, V. 1928, D. 87, *Mbledhja 5, e hanë, 12 mars 1928, Bisedim mbi Kodin Civil për herën e dytë (dalë nga komisioni)*.
Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, bot. Qendra e Publikimeve Zyrtare, Tetor 2012.
Kodi Civil i vitit 1929, bot. Papirus, Tiranë, 2010.
Lexique des termes juridiques, 16^{ème} édition, Dalloz, Paris, 2007.
Micro Robert, *Dictionnaire du français primordial*, S.N.L- Le Robert, Paris, 1977.
T. N. Dizdari: *Fjalor i orientizimeve në gjuhën shqipe*, bot. Instituti shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islam, Tiranë, 2005.
T. Selenica: *Shqipëria në 1937*, vëll. II, Tiranë, 1938.
V. Kondili: *E drejta civile*, II, pjesa e posaçme, bot. Geer, Tiranë, 2008.

⁴¹ Micro Robert, *Dictionnaire du français primordial*, S.N.L- Le Robert, Paris, 1977, f. 321.

⁴² *Lexique des termes juridiques*, 16^{ème} édition, Dalloz, Paris 2007, f. 245.